

## Trajtimi FunkSIONAL i thundrave

*Përgatitur nga Michael Hulek, Doktor Veteriner*

### Njohuri të përgjithshme

Bri i thundrave rritet rreth 4-6 cm në muaj. Nëse konsumimi i tyre është më i vogël se rritja, atëherë linden forma jo normale të thundrës (thundra stalle ose e deformuar). Në rastin e deformimeve nuk ndryshon vetëm forma e thundrës, por edhe vendosja (mbështetja) e këmbës zhvendoset nga prapa. Peshë e trupit nuk bie më në sipërfaqen mbështetëse të thundrave, por zhvendoset në pjesën e butë të pëllëmbës së thundrës (pulvinet).

Te thundrat e prera keq pjesa më e madhe e peshës së trupit zhvendoset në pjesën e jashtme të thundrës në këmbët e pasme, dhe në pjesën e brendëshme të thundrës në këmbët e përparme. Në këto raste linden dhimbje nga shtypja kur lopët qëndrojnë në këmbë dhe çalojnë më shumë kur lëvizin. Lopët që kanë dhimbje te thundrat qëndrojnë shtrirë për një kohë më të gjatë dhe shfaqin anoreksi. Kjo sjell edhe uljen e rendimentit të kafshës. Përveç rënies së rendimentit të qumështit janë vërejtur edhe probleme me cilësinë dhe përmbajtjen e qelizave somatike në qumësht.

Nuk bëhet fjalë në asnjë mënyrë për prerjen radikale të gjithë thundës, por duhet të kujdesemi që pas prerjes, peshë e trupit të shpërndahet njëtrajtësisht mbi thundra. Duhet ruajtur patjetër një trashësi prej rreth 5mm e shollës (tabanit). Kjo është e rëndësishme për lëvizjet në natyrë, lëndina dhe në stallë. Sipërfaqet me lagështirë në stallat me lëvizje të lirë shtojnë të tjera kërkesa nga ato të stallave me lidhje.

## “Kujdesi funksional i thundrave”

Kujdesi funksional i thundrave është sot metoda më e sukseshme dhe më e përhapur për përkujdesjen e thundrave në Europë. Procesi i punës kryhet në 5 faza. Nëse këto 5 faza zbatohen me rigorozitet, atëherë dhe rezultati do të jetë i kënaqshëm.

**Faza 1:** Korigjimi i gjatësisë së thundrave me darë thundrash ose me limë këndore. Fillohet me thundrën më të vogël. Gjatësia e murit të përparmë shkurtohet deri në 75 mm. Thundra më e gjatë do të përshtatet në gjatësi me atë më të shkurtrën.

**Faza 2:** Korigjimi i lartësisë së thundrave. Puna fillon me thundrën e vogël. Duhet të shmanget një prerje e thellë mbrapsht, pasi përndryshe nuk është më i mundur çlirimi i thundës së jashtme nga pesha. Më pas bëhet përshtatja e thundrës së madhe me të voglën. Duhet të ruhet gjatësia e murit të përparmë prej rreth 75 mm dhe trashësia e tabanit prej 5mm. Duhet të synohet një sipërfaqe e sheshtë mbështetje si në gjatësi ashtu dhe në gjerësi. Këndi nga pulvinet e thundrës tek muri i përparmë duhet të jetë rreth 50-60 gradë. Defektet në pjesën e shollës ose të murit për momentin nuk merren parasysh.

**Faza 3:** Bëhet një prerje speciale në mesin e thundrës. Nga sipërfaqja e tabaneve pritet në mesin e thundrës me një thikë speciale një thellim i sheshtë për ta çliruar atë pjesë. Kjo është para së gjithash e rëndësishme për thundrën e madhe për të shmangur shtypjet e lëkurës, pasi këtu shpesh formohen ulçerat e tabanit. Kanali i ndërmjetëm i thundrës pastrohet më mirë dhe mënjanon rrezikun e një acarimi të kanalit ndërmjetës.

**Faza 4:** Riparimi i difekteve të tabanit. Këtu hyjnë tabanet e dyfishta, pjesë të shtypura ose të çara në pjesën e vijës së bardhë. Tabanet e dyfishta mund të largohen në shumicën e rasteve pa problem. Pjesët e shtypura, të cilat dallohen nga ngjyra e kuqe e bririt, duhet të hiqen me kujdes. Briri jo i rritur me lëkurën duhet të hiqet në mënyrë që lëkura të mund të formojë një bri të ri. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të madhësisë, duhet menduar për çlirimin e saj duke ngjitur një pllakë druri mbi thundrën e shëndoshë.

**Faza 5:** Përpunimi i murit dhe i difekteve të majës. Briri i shpërbërë nga qelbëzimi apo lënia e lirë në pjesën e majës dhe të mureve anësore duhet të hiqet. Duhet

shmangur prerja e pjesëve të thella dhe zonës interdigitale. Muret anësore të shpërbërë duhet të priten mbrapsht për të lehtësuar peshën.

Është e rëndësishme që ti përmbaheni me saktësi 5 fazave të përshkruara më sipër, edhe pse është joshëse të riparosh menjëherë të gjitha difektet e konstatuara. Duhet patur gjithmonë parasysh se kryesor është sigurimi i një lëvizje sa më të mirë të kafshës. Përpara fillimit të kujdesit për thundrat, kafsha duhet të vihet në lëvizje për të gjykuar mbi çalimet, shqetësimet në procesin e të ecurit dhe zhvillimet jonormale të thundrës. Ky gjykim paraprak na jep më shumë siguri në punë. Për këtë gjykim paraprak duhet të vihet në dispozicion një sipërfaqe e sheshtë me gjatësi minimale rreth 6-8 metra.

Veglat më të rëndësishme

- Stativi për fiksimin e kafshës
- Thikë në formë ulluku dhe patkoi
- Darë thundrash
- Mprehës këndor

### **Metoda Ad-libitum për ushqimin e viçave**

Metoda e pirjes ad-libitum është furnizimi i vazhdueshëm dhe i pakufizuar i viçit. Ajo i përgjigjet nevojës natyrore të viçit për të konsumuar qumësht në sasinë e dëshiruar dhe kohën e dëshiruar nga gjiri i nënës. Me këtë metodë të ndryshme nga dhënia e racioneve të kufizuara, bëhet i mundur furnizimi optimal i viçit dhe përmbushja e potencialit gjenetik të rritjes.

Aparati tretës i viçit të sapolindur është i përshtatur posaçërisht për qumështin e papërpunuar. Në këtë fazë të jetës, konvertimi i ushqimit është shumë eficient. Kapaciteti i rritjes së viçit mund të stimulohet nëpërmjet furnizimit me lëndë ushqyese stabile dhe me tretshmëri të lartë, si qumështi i papërpunuar dhe zëvendësuesit e qumështit.

Përdorimi i metodës së pirjes ad-libitum shmang furnizimin e gabuar ose të pamjaftueshëm me lëndë ushqyese. Kjo sjell rritje të ritmit të rritjes (shtesa ditore më të larta), si dhe një përmirësim të dukshëm të shëndetit të viçit. Në këtë

mënyrë mund të reduktohen në minimum humbjet e viçave si dhe të arrihet një performancë optimale e fazës së rritjes.

Pirja ad-libitum zhvillohet nëpërmjet një kove thithëse, në 2-3 javët e para të jetës së viçit. Në rast të përdorimit të qumështit të plotë është i nevojshëm një acidifikim në pH 5,5 për shkak të ftohjes dhe kohës së ruajtjes. Përdorimi i zëvendësuesit ofron disa avantazhe në ekonomizimin e punës dhe përmirësimin e higjenës ushqimore. Zëvendësuesit e qumështit kanë cilësi konstante dhe përmbajnë të gjitha lëndët ushqyese të nevojshme për zhvillimin e një kafshe të shëndetshme dhe rezistente.

Nëpërmjet furnizimit ad-libitum mësohen të pijnë sasi të mëdha. Furnizimi i vazhdueshëm sjell një përthithje më të avashtë dhe të baraspeshuar të qumështit përgjatë ditës. Kjo mënyrë pirje e mbron viçin nga “mbipirja” dhe problemet e sistemit tretës. Nga eksperiencia e ushqimit ad-libitum me KALBI-MILCH duhet llogaritur me një konsum mesatar ditor prej 8-10 litra për viç në tre javët e para. Studimet mbi pirjen ad-libitum trejavore tregojnë një potencial të lartë rritje në javët e para prej mbi 600 g për kafshë në ditë. Në të njëjtën kohë është vënë re edhe një ulje e konsumit të koncentratit. Intesiteti i rrituri i ushqimit i përgjigjet më mirë nevojave të vicit, si dhe mbështet një përthithje më të mirë të ushqimit të thatë në fazat e mëvonshme të jetës. Me intesitetin e lartë të javëve të para dhe me racionimin gradual të ushqimit duke filluar nga java e trete, mund të arrihet një dyfishim i peshës së lindjes deri në javën e tetë.

**Përfundim:** Intesiteti i lartë i ushqimit është baza për një fazë rritëse sa më të shpejtë dhe të suksesshme. Zëvendësuesit cilësor të qumështit si KALBI-MILCH këshillohen pa kufizim për pirjen ad-libitum dhe japin rezultate optimale rritje.